



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 3265 prot.

Himarë, më 06.08.2021

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE PËR PRANIMIN NË NIVELIN BAZË NË SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, si dhe kreu III i VKM-së nr. 520, datë 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, dhe kërkesës më nr. 45 prot. datë 05.08.2021 të bërë nga Shefi i sektorit të MZSH-së Himarë, drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, njofton shpalljen për:

1 (një) vend të lirë pune në pozicionin: Luftues zjarrfikës – në sektorin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (MZSH)

Afati për dorëzimin e dokumenteve është deri më datën: 16.08.2021

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e marra për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut.

Luftues zjarrfikës është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë dhe pronës. Duhet të njohë dhe të zbatojë orarin e veprimeve, të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në çdo kohë në gatishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njohë dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjediseve, teknikës, paisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë, me kolegët duke pasqyruar një figurë qytetare dhe humane.

Kriteret për pranimin e kandidateve në shërbimin e MZSH-së:

Kandidati për pranimin në nivelin bazë të shërbimit të MZSH-së duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;
- Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.
- Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.
- Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C";
- Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë profesione si mekanik, shofer, hidraulik, marangoz, infermier, elektrikist etj.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë;

- Formular aplikimi ;
- Fotokopje e kartës së identitetit ;
- Certifikatë familjare;
- Certifikatë personale;
- Një kopje të jetëshkrimit(CV);
- Një numër kontakti, e-mail, si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- Fotokopje të noterizuar të deftesës së pjekurisë, apo të diplomës;
- Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton "gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar";
- Vërtetim nga Gjykata, si dhe nga Prokuroria;
- Vërtetim i Gjendjes Gjyqesore dhe formular vetëdeklarimi ;
- Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);

- Certifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "C";
- Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Fotografi (2.5 x 3.5 cm), 2 (dy) copë.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, brenda datës 16.08.2021.

Në përfundim të afatit të verifikimit paraprak, *drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse* do të shpallë në faqen e internetit të Bashkisë Himarë dhe në stendat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër si dhe për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në Bashkisë Himarë. Afati i ankimit është 2 (dy) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohen fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- Testim me shkrim;
- Testim i aftësive fizike;
- Intervistë me gojë;
- Testimi psikologjik;
- Verifikim përfundimtar i aplikantit.

Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:

1. Testimi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.
2. Testimi i aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.
3. Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.
4. Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%.

Kandidatët fitues do të renditen sipas pikëve të mara dhe përzgjedhja e kandidateve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marë më shumë pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himarë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për vlerësimin përfundimtar. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në Bashkisë Himarë. Afati i ankimit është 2 ditë nga data e shpalljes dhe njoftimit të rezultateve të testimit.

BASHKIA HIMARË

Drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse

